



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA KLINË
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

KOMUNA E KLINËS

Nr.No.Br. 06-3962/17

Data-Date-Datum 01.08.2017

Klinë-Klina

RREGULLORE
PËR
TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME

Klinë, Korrik 2017

Në bazë të nenit 11 si dhe në pajtim me nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja (c), të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, pastaj nenit 9 të Ligjit nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 2 parag. 1 dhe nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme si dhe nenit 2 të Ligjit nr. 04/L-100 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e paluajtshme nr. 03/L-204, si dhe duke iu referua nenit 1 dhe frymës juridike të dispozitave tjera të Udhëzimit Administrativ të MEF-it nr. 03/2011 për Mbledhjen dhe Regjistrimin e informative mbi pronën dhe tatimpaguesin dhe se fundmi në bazë edhe të nenit 10 parag. 1 pika 3 të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, me propozimet e Debatit me Publikun të mbajtur me 13.07.2017 si dhe rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 17.07.2017, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e vetë të rregullt të VII-të më radhë për vitin 2017, të mbajtur më 28.07.2017, e miraton:

R R E G U L L O R E N P Ë R P Ë R T A T I M I N N Ë P R O N Ë N E P A L U A J T S H M E

I. D I S P O Z I T A T E P Ë R G J I T H S H M E

Neni 1

Përkufizimet

Të gjitha nocionet dhe përkufizimet që janë përdorur në këtë rregullore janë të sqaruara në nenin 3 të Ligjit bazë për Tatimin në Pronën e Paluajtshme si dhe nenin 2 të Udhëzimit Administrativ të MEF-it nr.03/2011 për Mbledhjen dhe Regjistrimin e informative mbi pronën dhe tatimpaguesin, kjo për faktin se në mënyrë analoge nocionet dhe përkufizimet e përdorura në këtë rregullore rrjedhimisht janë të njëjta dhe e kanë kuptimin e njëjte juridik më ato të përdorura në ligjin dhe udhëzimin e përmendur.

Neni 2

Qëllimi i rregullores

1. Kjo Rregullore ka për qëllim caktimin e tatimit mbi pronën e paluajtshme dhe parashtron standardet dhe procedurat, të cilat duhet t'i respektojë Komuna gjatë administrimit të kësaj takse, krejt kjo në harmoni me qëllimin e ligjit përkatës bazë dhe udhëzimit administrative që i referohet lemise së tatimit në pronë.

2. Tatimi në prone është taksë vjetore komunale, ndërkaq qe të hyrat e vjela nga tatimi mbi pronë do të derdhën në llogari të komunës dhe do të përdoren nga ajo për përmirësimin e infrastrukturës në territorin e komunës në përputhje me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësit.

II. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 3

Caktimi i tatimit në pronë

Tatimi mbi pronën caktohet për tërë pronën e paluajtshme në Komunë, me përjashtim të pronës, e cila lirohet nga tatimi në përputhje me nenin 7 të kësaj rregulloreje.

Neni 4

Tatimpaguesi

1. Personi përgjegjës për pagesën e tatimit në pronë (më tej: *tatimpaguesi*), para së gjithash është pronar i pronës.
2. Nëse pronari i pronës nuk mund të përcaktohet ose nuk mund të gjendet, tatimpagues është personi fizik ose juridik, i cili e shfrytëzon ligjërisht ose e mban pronën e paluajtshme.
3. Nëse pronari ose shfrytëzuesi i ligjshëm i pronës së paluajtshme, nuk mund të përcaktohet ose mund të përcaktohet, por nuk ka qasje ndaj pronës së paluajtshme, tatimpagues do të jetë personi fizik ose juridik i cili e shfrytëzon pronën.
4. Vendimi i tillë mbi përcaktimin e tatimit në pronë nuk prejudikon të drejtën përkatëse pronësore.

Neni 5

Baza e tatimit për caktimin e tatimit për pronën

1. Bazë e tatimit për tatim në pronë do të jetë vlera e pronës në treg, e përcaktuar në pajtim me standardet dhe procedurat e caktuara në përputhje me legjislacionin pozitiv të kësaj lëmie si dhe nenin 12 të kësaj Rregulloreje.
2. Vlerë e tregut e cilëso pronë për çdo vit tatimor, është vlera e pronës më 31 dhjetor të vitit paraprak, bazuar në dokumentacionin valid kontratat valide të shitblerjes, hipotekave, informative lidhur me qiratë dhe vlerësimet e pronës qe bëhen në pajtim më nenin 13 të Ligjit bazë për Tatimin në pronën e paluajtshme.

Neni 6

Shkallët e tatimit

1. Kuvendi i Komunës i cakton tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore, në shkallën prej 0.15 % deri në 1 % të vlerës së pronës në treg, krejt kjo në pajtim më nenin 2 parag. 1 dhe 2 i Ligjit nr. 04/L-100 për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Tatimin në pronën e paluajtshme nr .03/L-204.
2. Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës:

- | | |
|---|-------|
| 2.1. Pronat rezidenciale, shtëpi, banesë..... | 0.20% |
| 2.2. Garazhet..... | 0.20% |

- 2.3. Pronat bujqësore..... 0.15%
- 2.4. Pronat komerciale..... 0.20%
- 2. Fushat sportive të mbuluara, mbuloja e pompave të derivateve të naftës, benzinës, plinit etj.....0.20%
- 2.5 Pronat industriale-prodhuese.....0.15%
- 2.6. Depot dhe magazinat.....0.20%
- 2.7. Pishinat, basenet për larje, hurdhhat e peshqve..... 0.15%.

3. Pronë e pa përfunduar është prona në ndërtim e sipër, që nuk I plotëson kushtet për shfrytëzim normal dhe që do të vlerësohet dyzet përqind (40%) e vlerës së pronave rezidenciale dhe më normë të tatimit të po këtyre pronave.

4. Sqarimi i kategorive të pronës më për se afërmi është bërë në nenin 3 dhe dispozitat tjera të Ligjit bazë për Tatimin në Pronë, ndërkaq që sqarimet lidhur më ndërtesat dhe sqarimet tjera janë dhenë në nenin 2, 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ të MEF-it nr. 03/2011 për Mbledhjen dhe Regjistrimin e informative mbi pronën dhe tatimpaguesit.

Neni 7 Zonat tatimore

Komuna e Klinës ka përcaktuar 3(tre) zona tatimore, dhe atë siç vijon:

1. **Zona e parë:** Përfshinë të gjitha objektet në qendër të qytetit të Klinës dhe të gjitha rrugët e qëndresë se qytetit si: Rrugën „Abedin Rexha,,; „Dëshmoret Kombit,,; „Lidhja e Prizrenit,,; „Mehmet Haxhaj,,; „Ymer Berisha,,; „Skender Rexhepi,,; „28 Nëntori,,; „Ali Kelemendi,,; „Hasan Prishtina,,; „Bajram Curri,,; „Ganimete Terbeshi,,; „Sheshi Ndue Perlleshi,,; „Marije Shllaku,,; „Avni Rustemi,,; „Sheshi Mujë Krasniqi,,; dhe „Sheshi Nenë Tereza,,.

Po ashtu në këtë zonë përfshihen të gjitha objektet afariste dhe komerciale që kanë qasje të drejt për drejt në rrugën regjionale dhe magjistrale Klinë-Pejë, pastaj Gjakovë-Klinë, Skenderaj-Klinë, Klinë-Istog dhe Klinë-Prishtinë.

2. **Zona e dytë:** Përfshinë lagjet që kufizohen më qendrën e qytetit të Klinës.
- 3.
4. **Zona e tretë tatimore:** Përfshinë të gjitha fshatrat-viset rurale të Komunës së Klinës.

Neni 8 Kategoritë e pronave dhe vlerësimi i tyre sipas zonave

1. Zonat tatimore dhe kategorizimin e tyre e benë komuna përmes dispozitave të kësaj rregulloreje.
2. Vlera e pronave përcaktohet sipas zonave të vlerësimit dhe janë shprehur në € për 1 m², si vijon:

Nr. Rend.	I.	II.	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X
Kat. Zon.	Shtëpi Ban.	Apartm. Banesë	Garazh Kom.	Pronë Indus.	Pronë Fushë sport. Mbul.pomp.	Pronë Bujq.	Depo Mag.	Hurdh Peshq.		Pishinë
I.	280	320	150	500	400	150	300	250	180	100

II.	220	280	120	400	400	150	280	200	170	90
III.	140	150	90	200	200	100	200	150	160	80

Neni 9 **Zbritja lidhur më vendbanimin kryesor**

Çdo person fizik, i cili me 1 mars ose para 1 marsit të një periudhe tatimore vendos se prona ose njësia e banimit i shërben si vend kryesor për banim, i lejohet zbritja prej dhjetëmijë 10,000.00€ nga vlera e tatueshme e pronës.

Neni 10 **Llogaritja e tatimit për objektet afariste të cilat nuk zhvillojnë afarizëm**

1. Të gjitha objektet komerciale, afariste dhe industrial, të cilat nuk janë aktive dhe nuk zhvillojnë afarizëm duhet të tatimohen më 70% të vlerës se tregut të objekteve komerciale.
2. Sektori kompetent komunal për çështjet e tatimit në pronë duhet të identifikoj objektet nga paragrafi i mëparshëm i këtij neni, dhe duke verifikuar gjendjen e atyre objekteve se a janë ato aktive apo jo në zhvillimin e afarizmit.
3. Nëse Sektori I Tatimit në pronë konstaton se ato objekte kanë filluar aktivitetin afarist për vitin vijues tatimor duhet të tatimohen më 100% të vlerës se tregut.
4. Vlerat e pronave bujqësore të braktisura do të caktohen në bazë të analizave të bëra për pronat përkatëse, me normën përkatëse dhe përqindjen që konfirmohet sipas ligjit.

Neni 11 **Lirimi nga tatimi mbi pronën e paluajtshme**

Institucionet dhe organizatat që lirohen nga pagesa e tatimit në pronë janë të përcaktuara në dispozitën e nenit 8 të Ligjit bazë nr. 03/L-204 për Tatimin në pronën e paluajtshme i dt. 07 tetor 2010, dhe kjo dispozitë ka zbatim të drejt për drejt nga komuna.

Neni 12 **Regjistrimi dhe informacioni mbi pronën**

Çështja e regjistrimit dhe informacioneve mbi pronën është e rregulluar më dispozitën e nenit 10 të Ligjit për tatimin mbi pronën e paluajtshme e cila dispozitë po ashtu ka zbatim të drejtpërdrejt nga komuna.

Neni 13 **Përgjegjësitë komunale**

1. Sa i përket pronës që është në juridiksionin e saj komuna është përgjegjëse për funksionet e më poshtme në administrimin e tatimit mbi pronës, dhe atë:
 - 1.1. Menaxhimi i informatave tatimore mbi pronën dhe futje e të dhënave në bazën qendrore;
 - 1.2. Vlerësimi i pronës;

- 1.3. Vjelja dhe vjelja e detyruar e tatimit mbi pronën dhe
- 1.4. Ankesat administrative, dhe
- 1.5. Përgatitja dhe lëshimi i faturave të tatimit.

2. Mënyra e vjeljes së tatimit caktohet më për se afërmi edhe më Udhëzimin Administrativ të MEF-it nr. 03/2011 për Mbledhjen dhe Regjistrimin e informatave për pronën dhe tatimpaguesin.

Neni 14

Informacioni lidhur me tatimin mbi pronë

1. Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim-Sektori i Tatimit në pronë duhet të themelojë dhe të mbajë një bazë të dhënash lidhur me tatimin mbi pronë, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në tatimin mbi pronën, adresat e pronës, adresat e poseduesve dhe të shfrytëzuesve të pronës, të dhënat mbi tokën dhe ndërtesat, vlerat e pronës, faturat e pronës dhe shënimet mbi pagesat e tatimit.
 2. Baza e të dhënave mbi pronën duhet të mbështetet në regjistrin e të drejtave mbi pronën dhe kadastrën e tokës. Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit përmes Agjencisë Kadastrale të Kosovës duhet të sigurojë bazën e të dhënave për tatimin mbi pronën dhe informacionin e nevojshëm nga regjistri mbi të drejtën në pronën e paluajtshme. Drejtoria duhet të sigurojë për Agjencinë Kadastrale të Kosovës po edhe MEF-in të dhënat nga baza e të dhënave mbi pronën, në intervale kohore që do të caktohen nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.
- 14.3 Informacioni mbi regjistrimet e pronës në bazë të të dhënave përkritazi me tatimin mbi pronën e paluajtshme, duhet të jetë në dispozicion të publikut.

Neni 15

Vlerësimi i pronës

1. Vlerësimi i pronës bëhet sipas vlerës së tregut të pronës që e përcakton komuna në pajtim me standardet e përcaktuara nga Udhëzimi Administrativ i MEF-it nr. 03/2011 për Mbledhjen dhe Regjistrimin e Informatave për pronën dhe tatimpaguesin, si dhe aktet tjera nënligjore të kësaj lëmie dhe dispozitave të kësaj rregulloreje.
2. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë duhet të lëshojë një udhëzim administrativ, me të cilin parashtrohen standardet unike të vlerësimit, sipas të cilave komuna e vendos vlerën e pronës në treg. Standardet përfshijnë variablet relevante të vlerësimit, siç janë vlera në pajtim me kontratën e shitjes së pronës së paluajtshme, e vlerësuar nga organi kompetent, të ardhurat të cilat krijohen nga prona, shpenzimet e ndërtimit, vendi, madhësia dhe gjendja e pronës. Standardet do të bazohen në një vlerësim të përgjithshëm, përveç rasteve kur prona shfrytëzohet për qëllime të veçanta ose për pronë unike.
3. Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit ekonomik e shqyrton dhe e përcjellë vlerën e tregut të çdo prone që është nën juridiksionin e saj për çdo tre deri në pesë vjet.
4. Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit ekonomik rivlerëson pronën çdo vjet, nëse janë kryer ndërtime të reja ose janë bërë përmirësime thelbësore në pronë dhe nëse ekziston ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e pronës.
5. Pronari ose shfrytëzuesi i pronës mund të kërkojë nga komuna rivlerësimin e pronës, kur prona ka pësuar dëm, për të cilin nuk është shkaktar ose përgjegjës pronari apo shfrytëzuesi, siç janë dëmet që mund të ndodhin nga thatësira, vërshimi, zjarri, tërmeti, lufta ose katastrofat e tjera.

6. Për çdo ndryshim të vlerës së pronës së paluajtshme në shumë mbi 20% të vlerës aktuale, tatimpaguesit janë të obliguar që këtë ndryshim ta paraqesin në komunë.

Neni 16 Faturat e tatimit

1. Varësisht nga kushtet e parashtruara në këtë Rregullore, Drejtoria kompetente për Financat dhe Zhvillimin ekonomik-Spektori i Tatimit në pronë autorizohet për të lëshuar faturat e tatimit vjetor mbi pronën e paluajtshme.

2. Lëshimi i faturave të tatimit mbi pronën bëhet para 31 marsit të secilit vit.

3. Fatura e tatimit mbi pronë duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- 3.1. Identifikuesin e bazës së të dhënave për tatimin mbi pronën;
- 3.2. Emrin e tatimpaguesit;
- 3.3. Adresën e pronës;
- 3.4. Adresën për dërgimin e faturës së tatimit, nëse është e ndryshme nga adresa e pronës;
- 3.5. Vlerën e vlerësuar të pronës;
- 3.6. Tarifën e tatimit;
- 3.7. Detyrimin total të tatimit;
- 3.8. Datën kur duhet të bëhet pagesa e tatimit;
- 3.9. Procedurën për pagesën e faturës së tatimit dhe
- 3.10. Shqyrtimin dhe të drejtën për t'u ankuar, së bashku me procedurat e nevojshme.

Neni 17 Pagimi i tatimit në pronë

1. Për çdo vit fiskal tatimi komunal mbi pronën e paluajtshme paguhet në 2 këste të barabarta me ose para 30 qershor dhe 31 dhjetor të vitit tatimor.

2. Pagesa e tatimit në pronë duhet të bëhet në tërësi nëse kërkohet të bëhet transfer i pronës apo ndërrim i pronarit qoftë ai tatimpagues i ligjshëm, shfrytëzues i ligjshëm apo shfrytëzues tjetër sipas nenit 5 të Ligjit bazë për Tatimin në pronën e paluajtshme.

3. Pagesa e tatimit për pronat e ish ndërmarrjeve shoqërore të privatizuar duhet të bëhet sipas llogaritjeve të përputhshme me Ligjin për Tatimin e pronës së paluajtshme, duke përfshirë këtu edhe llogaritjen e dënimit dhe kamatës sipas neneve 20 dhe 21 të Ligjit bazë për Tatimin e pronës së paluajtshme, krejt kjo sipas edhe nenit 3 tani të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Tatimin në pronën e Paluajtshme nr. 04/L-100 të dt. 20 prillë 2012.

Neni 18 Shtyrja e pagesës së tatimit

1. Drejtoria për Financa dhe Zhvillim ekonomik, në rrethana të veçanta, të cilat do të shkaktonin vështirësi të tepruara për tatimpaguesin, mund t'i lejojë tatimpaguesit që ta shtyjë pagimin e tatimit. Kjo shtyrje e pagesës aplikohet vetëm për një faturë specifike të tatimit për pronën e cila është faturë për pronën primare të tatimpaguesit.

2. Tatimpaguesit të cilët kërkojnë ndihmë sipas këtij neni do të paraqesin dëshmi të vërteta të cilat e mbështesin ankesën e tyre për ngarkesë të tepërta. Shtyrja e tatimit mund të lejohet për aq kohë sa tatimpaguesi i plotëson kualifikimet për ngarkesë të përcaktuara më këtë rregullore.

3. Të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera të shtymjës se pagesës se tatimit mbi pronë janë të përcaktuara më për se afërmi ne nenin 16 të Ligjit bazë për Tatimin mbi Pronën e paluajtshme dhe Udhëzimin Administrativ të MEF-it nr. 03/2011 për Mbledhjen dhe Regjistrimin e informative mbi pronën dhe tatimpaguesin.

Neni 19

E drejta e pengmarrjes për tatim

1. Sipas kësaj Rregulloreje, çdo mospagim i tatimit të pronës përbën të drejtën e pengmarrjes në dobi të Komunës.
2. Nëse Komuna e regjistron të drejtën e pengut në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme, një e drejtë e tillë e pengut do të ketë përparësi mbi të gjitha të drejtat e tjera të pengmarrjes të dorëzuara më vonë. Pas pagesës së plotë të borxhit të tatimit, e drejta e pengut do të përfundojë.
3. Personi, pasuria e të cilit i nënshtrohet të drejtës së pengut, mund të ankohet në komunë për t'u liruar nga e drejta e pengut, në rast se pohohet se është bërë gabim me rastin e parashtrimit të kërkesës për të drejtën e pengut.

Neni 20

Vjelja e detyruar e tatimit

1. Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim-Zyra e Tatimit në pronë duhet të emërojë tatimvjelësit për të zbatuar vjeljen e tatimit mbi pronë.
2. Nëse tatimpaguesi nuk e kryen pagesën e duhur, tatimvjelësit mund të lëshojnë vërejtjen e fundit me shkrim, me anë të së cilës shprehet qëllimi për të konfiskuar pronën personale e cila i takon personit të tillë. Vërejtja e tillë duhet:
 - 2.1. T'i dërgohet tatimpaguesit (dhe do të konsiderohet e vlefshme madje edhe në rastet kur tatimpaguesi refuzon për të pranuar dokumentin),
 - 2.2. Të shpallet në vendbanimin apo lokalet e punës së tatimpaguesit, ose
 - 2.3. Të dërgohet me postë në adresën e fundit të ditur të tatimpaguesit.
3. Nëse tatimpaguesi nuk e paguan shumën e plotë të tatimit të papaguar me dënimet dhe kamatat brenda 10 ditësh pas dorëzimit të vërejtjes përfundimtare për tatimpaguesin, do të jenë të ligjshme për tatimvjelësit që:
 - 3.1. T'ia lëshojnë njoftimin mbi konfiskimin personit, i cili ka detyrim t'i paguajë tatimpaguesit pagë, qira ose borxh tjetër;
 - 3.2. T'ia lëshojë një njoftim për konfiskim bankës ose palës tjetër të tretë lidhur me pasurinë e tatimpaguesit që është në posedimin e tij;
 - 3.3. T'i përfundojë shërbimet komunale lidhur me pronën e tatimpaguesit, dhe

3.4. Të konfiskojë dhe të shesë në procedure ligjore pronën personale të tatimpaguesit.

4. Nga konfiskimi lirohen: ndihmat për fëmijë dhe ndihmat sociale, veshmbathja themelore, ushqimi themelor, orenditë themelore, gjërat themelore personale, mjetet e punës së tatimpaguesit.

Neni 21

Humbja e të drejtës mbi pronë

Neni 18

1. Nëse pas dy vjetësh nga njoftimi përfundimtar i pagesës së tatimit borxhi i tatimpaguesit nuk është paguar, atëherë Drejtoria mund t'ua dërgojë një njoftim për konfiskimin e pronës së paluajtshme apo konstituimin e të drejtës së hipotekës së pronës së paluajtshme të gjithë personave që kanë interes për atë pronë të paluajtshme.

2. Të gjitha kriteret ligjore që përcaktojnë humbjen e të drejtës mbi pronën janë të specifikuar në dispozitën e nenit 19 parag. 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Ligjit për Tatimin e Pronës së paluajtshme.

Neni 22

Dënimet

Çështja e dënimeve dhe procedura lidhur me to janë të përcaktuara në dispozitën e nenit 20 të Ligjit bazë për Tatimin në Pronën e paluajtshme dhe ajo dispozitë zbatohet drejt për se drejti nga komuna.

Neni 23

Kamata

Kamata dhe zbatimi i saj është e përligjua në dispozitën e nenit 21 të Ligjit për Tatimin mbi Pronën e paluajtshme.

III. PROCEDURA E ANKIMIMEVE

Neni 24

Ankesat administrative lidhur me faturat e tatimit mbi pronën e paluajtshme

1. Tatimpaguesi, i cili nuk pajtohet me vendimin e lëshuar nga Bordi komunal, mund të ushtroj ankesë brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të vendimit të Bordit komunal, dhe atë:

1.1. Deri më 30 nëntor 2012 në komisionin për shqyrtimin e ankesave në Ministrinë e financave.

1.2. Nga 1 dhjetori 2012 në Divizionin Fiskal të Departamentit për çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë në pajtim me nenin 81 B parag. 2 pika 2.6 të Ligjit nr. 04/L-102 të dt. 19 prillë 2012 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe procedurat.

2. Nëse Bordi komunal nuk ka marr vendimin brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita në të cilën ankesa ishte dorëzuar, tatimpaguesi mund të ushtrojë ankesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në organin gjyqësor të përcaktuar në pikën 24.1 të kësaj rregulloreje.

3. Tatimpaguesi i cili nuk pajtohet me vendimin e lëshuar nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave në Ministrinë e Financave, mund të ankohet në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve të pranimit të vendimit, deri më 30 nëntor 2012.

4. Nga 1 dhjetori i vitit 2012 gjykatë kompetente për të pranuar ankesat kundër vendimit të lëshuar nga organi kompetent për shqyrtimin e ankesave në Ministrinë e Financave, është Gjykata Themelore në Prishtinë.

5. Në procedurën e ankesës, për çështje që nuk janë paraparë me Ligjin për Tatimin në Pronën e paluajtshme gjënë zbatim Ligji nr. 04/L-102 i dt. 19 prillë 2012 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën tatimore dhe procedurat.

Neni 25

Autorizimi për lëshimin e faturave të tatimit për pronën e paluajtshme

1. Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim duhet të ketë autorizimin valid për lëshimin e faturave të tatimit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me qëllim të lëshimit të faturave të tatimit dhe vjeljes së tatimit mbi pronën në përputhje me ligjin dhe këtë Rregullore.

2. Për të marrë autorizimin e tillë, komuna duhet të dëshmojë para Ministrisë së Financave, se ajo:

2.1. I ka identifikuar dhe regjistruar karakteristikat fizike të pronës së tatueshme me pronën e cila lirohet nga tatimi;

2.2. Ka themeluar një bazë të të dhënave tatimore mbi pronën;

2.3. Ka zbatuar kriteret e vlerësimit në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 13 të Ligjit për Tatimin në pronën e paluajtshme dhe nenin 15 të kësaj rregulloreje;

2.4. Ka caktuar tarifatat tatimore mbi pronën në pajtim me këtë Rregullore, dhe

2.5. Ka treguar aftësinë administrative për të kryer menaxhimin e informimit mbi pronën, vlerësimin e pronës, faturimin, vjeljen, vjeljen e dhunshme dhe ankesat administrative.

3. Të gjitha autorizimet tjera ligjore sa i përket komunës lidhur me certifikimin, pastaj inspektimin si dhe çështjet tjera janë të specifikuar në dispozitën e nenit 23 parag. 3, 4, 5 dhe 6 të Ligjit për Tatimin mbi pronën e paluajtshme dispozitë kjo që ka zbatim të drejtpërdrejt nga komuna.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 26

Zbraztësira juridike dhe ligjore dhe rregullimi i saj

Në rast të zbrazëtirës juridike nga rregullativa komunale lëndore apo kolizionit të saj me dispozitat përkatëse sistemore ligjore zbatohen drejtë për se drejti dispozitat sistemore ligjore si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tyre që rregullojnë çështjen e tatimit mbi pronën e paluajtshme dhe shkallet tatimore vjetore, si dhe ato të akteve të tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe dispozitat tjera të Udhëzimeve përkatëse administrative të Ministrisë së Financave dhe Administratës tatimore, deri në harmonizimin e kësaj rregulloreje.

Neni 27
Hyrja në fuqi e rregullores

1. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjese për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqën zyrtare të komunës, kjo në kuptim të nenit 18 të Rregullorës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/2013 dt.24.01.2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të akteve komunale.

2. Kjo Rregullore shfuqizon Rregullorën për Caktimin e Tatimit në pronën e paluajtshme (Teksti i spastruar) nr. 01-434-3472 e dt.28 shtator 2007, së bashku me të gjitha vendimet tjera të mëvonëshme të veqanta për konfirmimin e shkallve tatimore vjetore.

Neni 28
Zbatimi dhe mbikëqyrja e rregullores

1. Zbatimi i kësaj rregulloreje bëhet nga të gjitha drejtoritë e Komunës së Klinës, dhe organet e tjera kompetente administrative komunale që janë të obliguara për zbatimin e tatimit në pronë sipas ligjit dhe kësaj rregulloreje.

2. Kryetari i Komunës bën mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregulloreje.

Neni 29
Publikimi dhe transparenca e rregullores

Për njoftim rregullorja publikohet në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës, si dhe në ueb faqen zyrtare të Komunës së Klinës, në kuadër të portalit qeveritar, një kopje MAPL-ës në Prishtinë dhe një arkiva.

KUVENDI I KOMUNËS NË KLINË

Nr. 01- 06-3962 /2017
Klinë, më dt. 01.08 2017.

